



UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 35/2 Prot.

Durrës, më 9.01.2020

VENDIM

Nr. 2, datë 9.01.2020

PËR

"MIRATIMIN DHE SHPËRNDARJEN E BURSIVE, PËR VITIN AKADEMIK 2019-2020, PËR STUDENTËT TË CILËT PËRMBUSHIN KRITERET PËR PËRFITIMIN E BURSIVE NGA FONDI I MBËSHTETJES STUDENTORE PËR STUDENTËT E SHKËLQYER, QË NDJEKIN STUDIMET NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE, PRANË UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU", DURRËS.

Në zbatim të ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", nenin 49 të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Insitucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 903, datë 21.12.2016, të ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 784, datë 26.12.2018 "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 903, datë 21.12.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë", të ndryshuar me Vendimin nr. 784, datë 26.12.2018 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar me Vendimin nr. 39, datë 23.01.2019 të Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime në VKM 903, dt. 21.12.2016 Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studenët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë", të ndryshuar ,shkresës nr. 6216 prot., datë 25.11.2019 të Fakultetit të Edukimit "Përcillen listat e studentëve të ciklit të parë të studimeve, me mesatare 9 deri 10, të cilët përfitojnë përjashtim/reduktim nga tarifa e studimit si dhe për trajtimin me bursë për vitin akademik 2019 - 2020", Bordi i Administrimit i Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, në mbledhjen e datës 09.01.2020,

VENDOSI:

1. Shpërndarjen e bursave, për vitin akademik 2019 - 2020, për 32 studentë të cilët vijnë studimet në vitin e dytë ose të tretë të ciklit të parë të studimeve pranë Fakultetit të edukimit, sipas listës së përcjellë nga ky fakultet me shkresën nr. 6216, datë 25.11.2019.

2. Efektet financiare për mbulimin e shpenzimeve për shpërndarjen e bursave për vitin akademik 2019 – 2020 të miratuara në pikën 1 të këtij Vendimi, paraqiten sipas tabelës bashkëlidhur dhe do të përballohen nga fondet e buxhetit të shtetit (granti) i miratuar , nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për vitin 2020, për Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi:
- Administratori
 - Drejtorja e Administrimit Financiar

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BORDIT TË ADMINISTRIMIT



**TABELA PERMBLEDHESE MBI NUMRIN E STUDENTEVE TE CIKLIT TE PARE TE CILET
PERFITOJNE BURSE DHE EFEKTI FINANCIAR PER VITIN AKADEMIK 2019-2020**

MIRATUAR DATA 09.01.2020

Kriteri perfitues												
Shkresa referuese	Fakulteti	Numri i studenteve te cilet perfitojne burse per vitin 2019-2020	Efekti financiar per vitin akademik 2019-2020 (ne leke)	Studente qe vijne nga familje qe trajtohen me ndihme ekonomike	Studente qe jane vete me aftesi te kufizuara	Studente qe qe kane statusin "jetim"	Studente te shkelqyer viti I dyte dhe I trete	Studente te shkelqyer viti pare sipas shkrases se OSHA -se nr 5534 date 20.11.2019	Studentët, të cilët i kanë të dy prindërit me aftësi të kufizuara, të vërtetuara me vendim të Komisionit të Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për	Studentët, të cilët i kanë të dy prindërit pensionist ose njerin prind pensionist dhe tjetri nuk jeton	Studentët, të cilët janë të tretët e lart në rradhënë e familjeve në familje me tre fëmijë a më shumë, nga të cilët dy të parët janë student në insitucionet publike të arsimit të lartë	Bashkëshortët, të cilët kanë fëmijë dhe janë të dy student
Shkresa nr. 6216 date 25.11.2019	FE	32	2,880,000	-	-	-	32	-	-	-	-	-
TOTALI		32	2,880,000	-	-	-	32	-	-	-	-	-